

URDHËR
Nr. 575, datë 9.6.2025

PËR NDALIMIN E PËRKOHSHËM TË LËVIZJES SË KAFSHËVE TË GJALLA TË LLOJIT DHEN DHE DHI NË TERRITORIN E REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

Mbështetur në nenin 102, pika 4, të Kushtetutës, në shkronjën “b”, të nenit 15, të ligjit nr. 10465, datë 29.9.2011, “Për shërbimin veterinar në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar;

URDHËROJ:

1. Ndalimin e përkohshëm të lëvizjes së kafshëve të gjalla të llojit dhen dhe dhi, nga ferma në fermë, shtegtimin dhe kullotjen në kullota, në të gjithë territorin e Republikës së Shqipërisë.
 2. Ndalimin përkohshëm të tregtimit të kafshëve të gjalla të llojit dhen dhe dhi në tregjet e kafshëve të gjalla, mjedise të hapura, panaire dhe grumbullime të tjera në të gjithë territorin e Republikës së Shqipërisë.
 3. Lejohet lëvizja e kafshëve të gjalla të llojit dhen dhe dhi vetëm për në thertore, e shoqëruar me certifikatë shëndetësore veterinare, e lëshuar nga veterineri zyrtar.
 4. Për zbatimin e këtij urdhri ngarkohen Drejtoria e Përgjithshme e Zhvillimit në Fushën e Sigurisë Ushqimore, Veterinarisë, Mbrojtjes së Bimëve dhe Peshkimit, Autoriteti Kombëtar i Veterinarisë dhe Mbrojtjes së Bimëve, Autoriteti Kombëtar të Ushqimit dhe Instituti i Sigurisë Ushqimore dhe Veterinarisë.
- Ky urdhër hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

MINISTËR I BUJQËSISË DHE ZHVILLIMIT RURAL
Anila Denaj